



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za žalbe i Predstavke

Anr.178/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Vlerona Maliqi, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër koalicionit AAK&PSD, me seli në Prishtinë, për shkak të përfshirjes së të punësuarve në institucionet shtetërore dhe publike në fushatë zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me 04.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa Anr.178/2019 e datës 01.10.2019, e paraqitur nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, kundër koalicionit AAK&PSD, me seli në Prishtinë, për përfshirjen e të punësuarve në institucionet shtetërore dhe publike në fushatë zgjedhore.

A r s y e t i m

Subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, ka paraqitur ankesë në PZAP më datë 01.10.2019, me të cilën pretendon se më datë 01.10.2019, rreth orës 17:20, nga ana e aktivistëve të LVV-së, qendra në Prishtinë, është vërejtur se nga ana e kandidatit për kryeministër, nga radhët e koalicionit AAK&PSD, Ramush Haradinaj, në llogarinë e tij në facebook, diku rreth orës 13:20, janë publikuar fotografi, të realizuara pas një vizite në Qendrën Studentore në Prishtinë, Konviktet e Qëndrimit dhe Qendrën e Ushqimit, veprim ky i cili sipas paraqitësit të ankesës, bie në kundërshtim me nenin 35 të LZP-së dhe nenin 1 të Rregullës Zgjedhore Nr.20/2019. Në fund ka kërkuar nga PZAP-i, që koalicioni AAK&PSD, të sanksionohet sipas legjislacionit në fuqi.

Paraqitësi i ankesës si dëshmi për pretendimet e tij, ankesës i ka bashkangjitur disa fotografi të printuara, në cilësi të provave materiale.

Në përgjigje në ankesë të datës 02.10.2019, koalicioni AAK&PSD, lidhur me pretendimet ankimore të subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), ka theksuar se vizita e z.Ramush Haradinaj, në Qendrën e Studentëve, është bërë në kuadër të kompetencave të tij si kryeministër në detyrë, për të uruar vitin e ri akademik dhe se asnjë moment gjatë vizitës nuk është shfrytëzuar për fushatë zgjedhore, ku pamjet filmike në media, flasin qartë se vizita ka qenë zyrtare. Në fund ka propozuar që gjatë marrjes së vendimit, PZAP-i, të marrë parasysh njoftimet që ka bërë koalicioni AAK&PSD, për të gjitha strukturat dhe mbështetësit e tij për respektimin e rregullave zgjedhore, të cilat janë bashkangjitur në cilësi të provave, në përgjigje në ankesë.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e pabazuar

Paneli me rastin e shikimit të shkresave të lëndës, vlerësoi se paraqitësi i ankesës nuk ka arritur që me sukses t'i argumentojë pretendimet e veta, pasi që nga fotografitë të cilat paraqitësi i ka bashkangjitur si dëshmi ankesës, nuk mund të vërtetohet nga ana e kandidatit për kryeministër nga radhët e koalicionit AAK&PSD, Ramush Haradinaj, në fushatën e zgjedhjeve janë përfshirë kategoritë e personave të punësuar në institucionet shtetërore dhe publike gjatë orarit të rregullt të punës.

Nga fotografitë të cilat gjenden në shkresat e lëndës, vërehet vetëm se është realizuar një vizitë në Qendrën e Studentëve, Konviktet e Qëndrimit dhe Qendrën e Ushqimit, në të cilin takim ka marrë pjesë edhe kandidati për kryeministër nga radhët e koalicionit AAK&PSD, Ramush Haradinaj, por nuk ka ndonjë dëshmi e cila provon faktin se kategoritë e personave në fjalë janë përdorë për fushatë zgjedhore, pasi që nga fotografitë nuk shihet se aty ka pasur ndonjë tubim politik apo çfarëdolloj materiali promovues të koalicionit AAK&PSD.

Pretendimet ankimore të paraqitësit të ankesës lidhur me shkeljen e pretenduar të Rregullës Zgjedhore Nr.13/2013, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregullën Zgjedhore Nr.20/2019, për "Fushatën e Zgjedhjeve dhe Njoftimin për Ngjarjet Politike", respektivisht nenin 5 par.2, pika a), nga ana e koalicionit AAK&PSD, Paneli vlerësoj se janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se, veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura të Rregullës Zgjedhore, me të cilat sanksionohet përfshirja në fushatë zgjedhore e kategorisë së personave të punësuar në institucionet shtetërore dhe publike, gjatë orarit të rregullt të punës. Poashtu, Paneli nuk gjeti se nga ana e kandidatit në fjalë është bërë shkelje e sanksionuar me nenin 35 të LZP-së, andaj në mungesë të provave, paneli e refuzoi ankesën e subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë.

Parashtruesi i ankesës me asnjë provë nuk arriti të argumenton se kandidati për kryeministër nga koalicioni AAK-PSD njëherësh kryeministri në detyrë Ramush Haradinaj, me qëllim të promovimit për fushatë ka përdorur kategorinë e personave në fjalë, pasi ka rastisur se vizita dhe hapja e Qendrës së Studentëve të jetë në kohën e zhvillimit të fushatës. Në videon e dorëzuar si provë, nuk vërehet asnjë shenjë apo element propagandistik, po ashtu nuk ka llogo apo simbol të fushatës së subjektit të cilit i përket kryeministri.

Paneli në kuptim të nenit 115.1 dhe neni 118 par.1 të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.178/2019 më datën 04.10.2019

Kryesuesi i Panelit
Faton Ademi



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.